



Policia e Kosovës

PARANDALO VJEDHJET ME THYERJE


Para se te dilni nga shtëpi sigurohuni që dyert dhe dritaret janë të mbyllura plotësisht.



Siguroni pjesën e pasme të kopshti duke mbyllë me çelës, çdo derë. Hajdutët përdorin mjetet e kopshtit për të thyer dhe hyrë brenda, kështu që kujdesuni të mbyllni çdo mjet që mund të përdoret.



Çelësat e shtëpisë dhe të veturës duhet të mbahen në vend të sigurt. Mos i leni të duken në dritare, hyrje të shtëpisë, korridore ose kuzhina.



Mundesisht, shkruaj te dhenat e pajisjeve elektronike (laptop, TV, telefonat mobil) me qellim që te lokalizohen nga policia me rastin e aktivizimit të tyre.



KUJDESUNI PËR XHEPIN TUAJ !

Personat që kryejnë këto vjedhje zakonisht shfrytëzojnë tollovitë e krijuara nga grumbujt e njerëzve

Këshillë:

- Mos e vendosni portofolin, telefonin celular dhe gjerat me vlere në xhepin tuaj të pasmë të pantallonave,
- Mos mbani shuma të mëdha të parave në portofolin tuaj .
- Bëni kujdes në treg kur ka tollovi të shkaktuar nga njerëzit .
- Bëni kujdes kur ndonjë person i panjohur për ju fillon që të ju shtyn dhe të njëjtën kohë kërkon falje nga ju .
- Të dyshuarit e këtyre veprave zakonisht operojnë në grupe dhe caku i tyre është të ju shpërqendrojnë vëmendjen juaj.



- Mos e vendos kodin – PIN-in e kartelës bankare, në portofolin tuaj.

Duke iu përmbajtur këtyre këshillave ju do të reduktoni mundësinë për të qenë viktimë. Nëse shihni njerëz apo sjellje të dyshimta, raportojeni menjëherë në Policinë në numrin 192.